



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**



**“PJESËMARRJEN E BASHKISË GJIROKASTËR NË SUBJEKTE ME
KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE
TË FURNIZIMIT MË UJË TË PIJSHËM , GRUMBULLIMIT, LARGIMIT, DHE
TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Ligji Nr.8102 datë 28.03.1996 , “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura” të ndryshuar, Vendimit Nr. 302, dt. 11.05.2022 “ Për Politikat Kombetare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujrave të Ndotura” , Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, në mbledhjen e datës 31/05/2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr 139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, për të negociuar me shoqëritë publike të ujësjellës kanalizimeve që aktualisht ushtrojnë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm , grumbullimit, largimit, dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe energjisë për mundësinë e lidhjes së marrëvjeshjes specifike.
2. për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.
3. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë “UK” , që pas krijimit të subjekteve me kompetenca të përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare , të vijojë me miratimin në Asamblenë e

Përgjithsme të Aksionereve te autorizimit për Administratorin e shoqërisë Aksionere "UK" për nënshkrimin e cdo akti të nevojshëm kontraktore dhe noteriale me qëllim transferim të veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

Lavdi Hasani

